



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 108, datë 29.07.2020

PËR

MIRATIMIN E UDHËZIMIT

**“PËR NIVELIN DHE STRUKTURËN E PAGAVE, SI DHE SHPËRBLIMEVE TË
PUNONJËSVE, TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV,
NËNDREJTORIT EKZEKUTIV DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE
JOEKZEKUTIVË TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 9 dhe nenit 14, pika 11, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e udhëzimit “Për nivelin dhe strukturën e pagave, si dhe shpërblimeve të punonjësve, të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, Nëndrejtorit Ekzekutiv dhe shpërblimin e anëtarëve joekzekutivë të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Udhëzimi nr. 76, datë 28.07.2015 “Për caktimin e shpërblimit të anëtarëve joekzekutivë dhe pagës së Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, Nëndrejtorit Ekzekutiv dhe të punonjësve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, shfuqizohet.
3. Efektet e këtij udhëzimi, hyjnë në fuqi me datë 15 shtator 2020.
4. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR
Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE